



AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM  
KOSOVO ACCREDITATION AGENCY  
AGENCIJA ZA AKREDITOVANJE KOSOVA

Nr. 631/16 Dt. 27.01.2016

Në mbështetje të nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) neni 15 (pika 1, 2 dhe 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (Nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013), nenin 126 dhe 136 të Ligjit mbi Procedurën Administrative, nr. 02/L-28, datë 22.07.2005, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen 39-të të mbajtur më 21 janar 2016, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e BPrAL Kolegji "Fama" nr.390/15, datë 17.09.2015 për njohje të akreditimit për programin e studimit: Business Administration (MBA), të institucionit "Northern Illinois University" nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky program i studimit është i akredituar nga "The Association to Advance Collegiate Schools of Business - AACSB" në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
- II. Kohëzgjatja e njohjes së akreditimit të programit të sipërpërmendur, është e njëjte me kohëzgjatjen e akreditimit që ka ky program i studimit në certifikatën e akreditimit të lëshuara me datë 24 mars 2014 nga "The Association to Advance Collegiate Schools of Business - AACSB" për institucionin "Northern Illinois University", në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

